



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 3218/1 Prot  
Dt. 10.06.22



Nr.365/1.prot.

Shkodër, më 10.06.2022

**LËNDA: Mbi vendimin Nr. 31 datë 26.05.2022 të Këshillit të Bashkisë Vau-Dejës.**

**KËSHILLIT TË BASHKISË VAU-DEJES**

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të kompetencave që i jep ligji Nr.107/2016 dt.2.10.2016 “Për Prefektin”, Urdhërit të Kryeministrit Nr.50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.175 dt.9.07.2020 “Për miratimin e rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”si dhe aneksi 1 “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, Kreu II, neni 4, Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, ligjit Nr.22/2018 “Për strehimin social”neni 15, pika 3, neni 16, VKM Nr.362 dat.29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qerasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qerasë në tregun e lirë, nepërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, VKB Vau-Dejës Nr.16 dat.28.03.2022 “Mbi miratimin e komisionit të strehimit për Bashkinë Vau-Dejës”, materialit dërguar nga këshilli bashkiak Vau-Dejës Nr.3214prot dat.1.06.2022 “Bashkëlidhur ju dërgojmë dokumentacionin shoqëruar të mbledhjes së këshillit bashkiak të datës 26.05.2022”, analizoi VKB Vau-Dejës Nr.31 date.26.05.2022 “Mbi miratimin e sistemit të pikezimit për programin e strehimit ”Subvencionim të qerasë në tregun e lirë, për vitin 2022, hartuar nga komisioni i strehimit i ngritur me vkb nr.16 dat.28.03.2022”.

Prefekti ju autorizon të procedoni konform procedurave të mëtejshme ligjore.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**P R E F E K T I**

**Majlinda ANGONI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS  
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 31 datë 26.05.2022

**“Për miratimin e sistemit të pikëzimit për programin e strehimit “ Subvencionimit të qiras, ne tregun e lire” për vitin 2022, i hartuar nga Komisioni i Strehimit i ngritur me VKB nr. 16 datë 28.03.2022.**

Në mbështetje të nenit 24, neni 54 gërma “n” e Ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar ; Ligji nr 22/2018 “ Për strehimin social”, neni 15 dhe neni 16, me propozimin e Komisionit të Strehimit i ngritur me VKB nr. 16 datë 28.03.2022:

**KËSHILLI BASHKIAK  
VENDOSI**

1. Miratimin e sistemit të pikëzimit për vitin 2022, i cili do përdoret për përzgjedhjen e subjekteve apo familjeve përfituese të programit të **“Subvencionimit të qiras, ne tregun e lire”, bashkëlidhur**.
2. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të Ligjit nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”

KRYETAR  
**Mark BISHA**

Sekretari i Këshillit Bashkiak  
**Ardian ÇELEPIJA**

Miraturar me 22 vota

Vota Pro 22

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me Datë 01.06.2022